

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK
Komisioni Financës, Taksave dhe Revizionimit

Nr. .Prot.

Rrogozhinë, më 23.12.2025

Raport vendimmarrjeje

Projektvendimi: Për miratimin e buxhetit të bashkisë rrogozhinë për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesem 2026-2028.

Analiza ligjore:

Ligji nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligji nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 6, shkronjat “ç” dhe “d”, nenit 33, pika 1, nenit 39, pika 1, nenit 40, nenit 41, pika 1 dhe 3 të ligji nr. 68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neneve 6, 15, 17 dhe 32, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; nenit 2, shkronja “c” dhe nenit 5, shkronjat “a” dhe “d”, Ligjit “Për Buxhetin e Vitit 2026”, ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të Vendimit nr.503 datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar”.

Situata aktuale e funksionit:

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të përgatitur nga Grupi për Menaxhimin Strategjik i paraqet për miratim Këshillit Bashkiak Rrogozhinë:

1.1. Plani i të ardhurave të Bashkisë Rrogozhinë për vitet 2026-2028 është si më poshtë:

në lekë

Nr	Burimet Buxhetore	2026 Parashikimi	2027 Parashikimi	2028 Parashikimi
1	Të ardhurat nga burimet e veta	243,042,494	246,472,828	247,120,688
2	Transferta nga buxheti qendror	359,502,270	366,923,472	374,161,581
3	Të ardhura nga taksat e ndara	22,941,000	22,630,000	22,853,000
4	Huamarrja			
5	Trashëgimi nga viti i kaluar	292,080,100	225,005,000	172,000,001

5	Trashëgimi nga viti i kaluar	292,080,100	225,005,000	172,000,001
	TOTALI	917,565,864	861,031,300	816,135,270

1.2 Plani i shpenzimeve të Bashkisë Rrogozhinë për vitet 2026-2028 është si më poshtë:

në lekë

Nr	Shpenzimet	Plani 2026	Plani 2027	Plani 2028
1	Shpenzime personeli (llog.ekon. 600,601)	404,272,271	425,414,915	446,685,657
2	Shpenzime korrente (llog.ekon.602,603,604,605,606,609,651)	343,695,093	260,616,385	189,449,613
3	Shpenzime kapitale te brendshme (llog.ekon. 230,231)	169,598,500	175,000,000	180,000,000
4	Shpenzime kapitale te huaja (llog.ekon 230,231)			
	TOTALI SHPENZIMEVE	917,565,864	861,031,300	816,135,270

2. Të miratojë detajimin e buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2026 si më poshtë:

- 2.1. Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë Rrogozhinë sipas pasqyrës, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2.2. Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë Rrogozhinë sipas pasqyrës, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2.3. Të miratojë planin e shpenzimeve të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2026 sipas pasqyrës, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2.4. Të miratojë planin e shpenzimeve për vitin 2026 sipas burimit të financimit si më poshtë vijon:
 - 2.4.1. Shpenzimet me burim financimi nga transfertat sektoriale janë sipas pasqyrës, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - 2.4.2. Shpenzimet me burim financimi nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme janë sipas pasqyrës, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - 2.4.3. Shpenzimet me burim financimi nga të ardhurat janë sipas pasqyrës, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2.5. Të miratojë planin e shpenzimeve kapitale të Bashkisë Rrogozhinë nga burimet e veta për vitet 2026-2028 sipas pasqyrës, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2.6. Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik për cdo program buxhetor për vitin 2027 janë sipas pasqyrës, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2.7. Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik për cdo program buxhetor për vitin 2028 janë sipas pasqyrës, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2.8. Ngarkohet Drejtoria e Financës të kryejë avancim të fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2026.

3. Miratimin e dokumentit përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Rrogozhinë, që i bashkëlidhet këtij projektvendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
4. Ngarkohen të gjitha Drejtoritë në varësi të Bashkisë Rrogozhinë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Analiza Financiare:

Fonde nga qeveria qendrore dhe nga buxheti i Bashkisë Rrogozhinë.

Drejtoria/Sektori pergjegjes:

Grupi për Menaxhimin Strategjik në Bashkinë Rrogozhinë

Monitorimi dhe raportimi:

Të gjitha drejtoritë e bashkisë Rrogozhinë dhe institucionet e varësisë.

Impakti social/grupet qe preken:

Banorët e Bashkisë Rrogozhinë

A eshte objekt konsultimi:

PO. Konsultimi publik është kryer sipas kalendarit të publikuar në faqen zyrtare të bashkisë po ashtu edhe në rrjetet sociale. Është realizuar në të gjitha Njësitë Administrative dhe njësinë qender.

Komisioni i përhershëm i **Financës, Taksave dhe Revizionimit** u mbledhë më datë 23.12.2025, dhe shqyrtoi projekt-vendimin e sipërpërmendur së bashku me relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komente:

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqeruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Këshillit bashkiak:

a- Kalimin e projektaktit ne mbledhjen e Keshillit per vleresimin e metejshem dhe per shqyrtim

- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit te projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:

Anëtarët e Komisionit

Alime Hoxha

Kryetare



Merilin Saraçi

Zëvendëskryetare



Enver Memolla

Anëtar



Gezime Met-hasani

Anëtar



Indrit Dedej

Anëtar

